| Realizimi | 708,363 | 587,404 | 191,651 | | 1,487,418 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| % | 73% | 95% | 71% | | 80% |
| Inkasimi nga uji-(B.Plan) | 1,019,237 | 651,131 | 282,763 | | 1,953,131 |
| Realizimi | 690,268 | 563,994 | 194,973 | | 1,449,235 |
| % | 68% | 87% | 69% | | 74% |

# 4 SHËRBIMI KOMERCIAL

## 4.1 Përmbledhje

Gjatë TM1 2026, Shërbimi Komercial ka vazhduar me aktivitetet e rregullta, duke përfshirë leximin/faturimin, inkasimin, kontrollat dhe veprimtari të tjera në përputhje me përgjegjësitë e këtij departamenti.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme gjatë kësaj periudhe ka qenë vazhdimi i procesit të integrimit të konsumatorëve në pjesën veriore të zonës së shërbimit. Aktivitetet janë fokusuar në identifikimin, regjistrimin dhe sistemimin e të dhënave të konsumatorëve, integrimin e tyre në sistemet operative dhe komerciale të kompanisë, si dhe përfshirjen graduale në proceset e faturimit, inkasimit dhe menaxhimit të shërbimeve. Ky proces ka kontribuar në rritjen e numrit të konsumatorëve të evidentuar, përmirësimin e bazës së të dhënave dhe krijimin e parakushteve për monitorim më efikas të shërbimeve në të ardhmen.

Në nivel të KRU-së, kemi shënuar:

- Rritje të inkasimit me **24.19%** krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar;
- Rritje të faturimit me **24.37%**;
- Një vlerë të inkasuar **350,603.42 €** më shumë sesa TM1 e vitit të kaluar.

Gjatë TM1 janë zbatuar një sërë veprimesh me qëllimi përmirësimin e arkëtueshmërisë, uljen e humbjeve dhe rritjen e transparencës së faturimit, si:

- Indetifikimi dhe legalizimi i konsumatorëve ilegal
- Leximi i saktë i ujëmatësve
- Dërgimi i vërejtjeve për borgjli
- Shkyçja e konsumatorëve debitor
- Rritje e numrit të konsumatorëve të regjistruar
- Verifikimi i të dhënave të konsumatorëve dhe harmonizimi i evidencave teknike e komerciale në kuadër të procesit të integrimit të pjesës veriore
- Përditësimi dhe harmonizimi i të dhënave të konsumatorëve në sistemin GIS
- Rritja e konsumatorëve me kontrata të shërbimit, etj.

Këto rezultate reflektojnë përmirësimin e vazhdueshëm të performancës financiare dhe efikasitetit të shërbimeve tona.

### Tabela 18. Krahasimi i Inkasimit & Faturimit për TM1 2025/TM1 2026

| N.J.O | TM1 2025 | | | TM1 2026 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Inkasimi | Faturimi | Shk.Inknë % | Inkasimi | Faturimi | Shk.Ink në % | Rritja në % e inkasimit 2025/2026 | Rritja ne € |
| Mitrovica | 524,636 | 603,693 | 86.90% | 690,268 | 764,504 | 90.29% | 23.99% | 165,633 |
| Vushtrria | 420,016 | 455,795 | 92.15% | 563,995 | 633,232 | 89.07% | 25.52% | 143,940 |
| Skenderaj | 153,943 | 154,054 | 99.93% | 194,974 | 206,877 | 94.25% | 21.04% | 41,031 |
| KRUM | 1,098,594 | 1,213,542 | 90.52% | 1,449,198 | 1,604,612 | 90.31% | 24.19% | 350,603 |

### Tabela 19. Inkasimi & Numri i Konsumatorëve dhe Mesatarja e Inkasimit për Konsumator

| NJO | | TM1 2026 | | |
|---|---|---|---|---|
| | Inkasimi | Numri konsumatorëve | Numri i konsumatorëve në GIS | Inkasimi mesatar/konsumator € |
| **Mitrovica** | 690,268 | 24,941 | 24,189 | 9.22 |
| **Vushtrria** | 563,995 | 21,626 | 20,932 | 8.69 |
| **Skenderaji** | 194,974 | 10,273 | 9,886 | 6.32 |
| **KRUM** | 1,449,197 | 56,847 | 55,007 | 8.49 |

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, mesatarja e të ardhurave të inkasuara për çdo konsumator është si më poshtë:

- **Mitrovica:**9.22€
- **Vushtrria:**8.69 €
- **Skenderaj:**6.32 €
- **Në nivel të KRU-së:** 8.49 € për konsumator

Këto shifra ofrojnë një pasqyrë të qartë të nivelit të inkasimit në secilin rajon, duke reflektuar performancën financiare të shërbimit në zona të ndryshme.

*Paralelisht me aktivitetet e inkasimit dhe faturimit, gjatë TM1 2026 është vazhduar procesi i regjistrimit dhe verifikimit të konsumatorëve në sistemin GIS. Nga gjithsej 56,847 konsumatorë të*

*evidentuar në sistemin komercial, 55,007 prej tyre janë të regjistruar edhe në GIS, që përfaqëson rreth 96.8% të bazës së përgjithshme të konsumatorëve.*

**Tabela 20. Kontratat e Shërbimit dhe Riprogramimit - Krahasimi**

| NJO | Kontrata –TM1 2025 | | Vlera | Kontrata –TM1 2026 | | Vlera € |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Shërbimi** | **Riprogramimi** | **Riprogramuar** | **Shërbimi** | **Riprogramimi** | **Riprogramuar** |
| Mitrovica | 664 | 107 | 64,269 | 951 | 148 | 126,783 |
| Vushtrria | 411 | 121 | 74,495 | 749 | 121 | 98,948 |
| Skenderaji | 218 | 14 | 6,904 | 697 | 22,678 | 23 |
| KRUM | 1,293 | 242 | 145,667 | 2,397 | 296 | 248,409 |

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, vihet re rritje e numrit të kontratave të riprogramimit. Megjithatë, vlera e borxhit të riprogramuar është **102,742€** më e lartë krahasuar me tremujorin e të vitit të kaluar.

**Tabela 21. Numri i Pagesave – Krahasimi**

| | TM1 2025 | | | TM1 2026 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| NJO | **Numri i Pagesave** | **Vlera e Pagesave** | **Pagesa mesatare perkons.pagues** | **Numri I Pagesave** | **Vlera e Pagesave** | **Pagesa mesatare perkons.pagues** |
| Mitrovica | 23,550 | 524,635 | 22.27 | 23,309 | 690,268 | 29.61 |
| Vushtrria | 18,662 | 420,015 | 22.50 | 22,707 | 563,995 | 24.83 |
| Skenderaji | 6,536 | 153,943 | 23.55 | 7,721 | 194,974 | 25.25 |
| KRUM | 48,748 | 1,098,593 | 22.53 | 53,737 | 1,449,237 | 26.96 |

Numri i pagesave në TM1 2026 është rritur krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 për **4,989 pagesa (nga 48,748 në 53,737)**, duke treguar zgjerim të aktivitetit të inkasimit. Ndërkohë, vlera e inkasuar ka shënuar një rritje të konsiderueshme prej **350,644 € (nga 1,098,593 € në 1,449,237 €)**, duke reflektuar përmirësim të dukshëm të performancës financiare.

Në nivel të përgjithshëm, përveç rritjes së numrit të pagesave, evidentohet edhe rritje e theksuar e vlerës totale të inkasuar, ndërsa pagesa mesatare për konsumator pagues është rritur nga **22.53 € në 26.96 €,** duke treguar një kontribut më të lartë për pagesë individuale.

Ky trend tregon jo vetëm rritje të volumit të pagesave, por edhe përmirësim të cilësisë së inkasimit, me fokus në arkëtimin e vlerave më të larta. Në përgjithësi, performanca gjatë TM1 2026 paraqet avancim të dukshëm në menaxhimin e të hyrave dhe disiplinën e pagesave krahasuar me TM1 2025.

Në vijim, paraqiten aktivitetet dhe aksionet e realizuara në terren, të cilat përfshijnë identifikimin e konsumatorëve ilegalë, regjistrimin e konsumatorëve të rinj dhe veprime të tjera relevante.

*Tabela 22. Të dhënat e ndryshme*

| TM1 2026 Nj.Operative | Konsumator Ilegal | Paushall - ujëmatës | Ujëmates të Përbashkët në Individual | Konsumator të rinj | Ndërrim ujëmatësi | Konsumator të pasivizuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Mitrovicë** | 6 | 17 | 6 | 197 | 112 | 32 |
| **Vushtrri** | 24 | 1 | - | 238 | 95 | 8 |
| **Skenderaj** | - | - | - | 143 | 82 | 22 |
| **Totali:** | 30 | 18 | 6 | 578 | 289 | 62 |

Aktivitet e kontrollit nuk kanë munguar, por identifikimi i kyçjeve ilegale tek konsumatorët ka qenë shumë i vështirë, pasi që jemi në sezonin dimëror dhe të gjitha kyçjet izolohen dhe nuk shfrytëzohen. Nga fillimi i TM1 kemi filluar me aktivitete më të shpeshta dhe më të detajuara rreth keqpërdorimeve.

*Tabela 23.* **Verifikimet dhe Montimet e Ujëmatësve**

| Njësit Operative | Verifikime | Montime |
|---|---|---|
| Totali | 4.700 | - |

*Tabela 24.* **Ankesat dhe Kërkesat e Konsumatorëve (CRM)**

| Ankesat/Kerkesat Komerciale | Ankesat Komerciale | Kërkesat Komerciale |
|---|---|---|
| Totali | 30 | 214 |

### 4.2 Aktivitetet lidhur me integrimin e Komunave Veriore

Gjatë periudhës 15 maj 2025 – 31 maj 2026, ekipet operative kanë realizuar aktivitete të vazhdueshme në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit në Mitrovicën e Veriut dhe Zveçan, me fokus në sanimin e defekteve, reduktimin e humbjeve të ujit dhe përmirësimin e funksionimit të sistemit.

Aktivitetet kanë përfshirë: rekrutim stafi, identifikimin e insitucioneve, vendosjen e ujëmatësve, sanimin e rrjedhjeve në rrjetin e ujësjellësit, debllokimin e kanalizimeve, zëvendësimin dhe shtrirjen e gypave, ndërhyrje teknike për përmirësimin e furnizimit me ujë, etj.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar **672 intervenime operative** dhe janë montuar ujëmatës në **19 institucione**, duke kontribuar në përmirësimin e menaxhimit të sistemit të ujësjellësit dhe monitorimit të konsumit në pjesën veriore të zonës së shërbimit.

Aktualisht kanë mbetur edhe **5 institucione** për t'u pajisur me ujëmatës në Mitrovicën Veriore dhe Zveçan.

Ndërsa sa i përket komunave: Leposaviç dhe Zubin Potok janë ende në fazën e identifikimit të konsumatorëve të kategorisë për insitucione dhe biznese.

## 4.2. Aktivitete tjera

- Vazhdimisht jemi angazhuar të rrisim prezencën e kompanisë tek konsumatorët, qoftë përmes publikimeve të shkresave për pagesa, aktiviteteve ngaterreni dhe formave tjera, po ashtu përmes RTK-s dhe portaleve apo formave tjera mediale.

- Kemi zhvilluar aktivitete të mëdha kohe me pjesëmarrjen tonë në procesin e rekrutimit të stafit për komunat veriore.

- Kemi realizuar takime dhe vizita të kohë paskohëshme nëpër Njësitë Operative dhe me akterët tjerë relevant.

- Kemi zhvilluar takime dhe grup punues për hartimin e një raporti të përbashkët KRU "Mitrovica" Sh.A. dhe "Trepça" Sh.A, me ç'rast kemi përafruar qëndrimet dhe tashmë kemi pagesën e parë nga ana e tyre.

- Takime të vazhdueshme në përafrimin e aplikacionit e-Comerce, ku tashmë e kemi funksional.

- Kemi përsëritur kërkesën për automjete në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, ku tashmë kemi 3 automjete të dhuruara për KRU-"Mitrovica".

- Jemi angazhuar edhe në hartimin e një vizioni për brand të ri të kompanisë dhe rritjes e prezencës më të madhe kudo në rajon por jemi në proces edhe më tutje.

- Në vazhdimësi kemi në fokus rritjen e nivelit të produktivitetit dhe përgjegjësisë tek secili punonjës.

# 5. SHËRBIMI TEKNIK

## 5.1 Distribuimi

Gjatë tre mujorit të parë 2026 ITU në Shipol jane distribuar 4,474,390 m$^3$, në ITU Balinc 1,723,164 m$^3$ si dhe në Zubin Potok 1,072,376 m$^3$ siç shihet në tabelën me poshtë. Ndërsa kur krahasohet me vitin e kaluar për të njëjtit muaj është distribuar për 190,589 m$^3$ më pak, siç shihet ne tabelën në vijim.

*Tabela 25. Distribuimi i ujit nga ITU*

| Uji i prodhuar- ITU | Shipol m$^3$ | Balinc m$^3$ | Zubin Potok | Totali m$^3$ |
|---|---|---|---|---|
| TM1 | 4,474,390 | 1,723,164 | 1,072,376 | 7,269,930 |
| Total | 4,474,390 | 1,723,164 | 1,072,376 | 7,269,930 |

*Tabela 26. Krahasimi i furnizimit nga ITU 2026 dhe 2025*

| Uji i prodhuar ITU-të | Viti 2026 m$^3$ | Viti 2025 m$^3$ | Diferenca m$^3$ (pa Zubin Potok) |
|---|---|---|---|
| TM1 | 6,197,554 | 6,765,491 | -190,589.0 |
| Total | 6,574,902 | 6,765,491 | -190,589.0 |

**Vërejte: Duhet theksuar se deri në muajin Korrik nuk kemi të dhëna të prodhimit të fabrikës në Zubin Potok dhe si e tillë kjo fabrikë deri atë muaj nuk mund të hyjë në llogaritjet e diferencës së prodhimit.*

## 5.2 Kualiteti i ujit

Gjatë tre mujorit sipas raportimeve nga menaxherët e fabrikave duke u bazuar në rezultatet e analizave fiziko-kimike ne laboratorët e fabrikave tona, rezultatet kanë qenë në suaza normale të standardeve për ujë te pijes. Kualiteti i trajtimit të ujit, dëshmohet edhe me analizat e kryera nga IKSH në Kosovë, dega në Mitrovicë,të cilat përputhen me vlerat e gjetura në ujin e pa përpunuar dhe të përpunuar në laboratoret tona.Instituti ka verifikuar edhe shume mostra tjera të kualitetit të ujit të cilat kanë rezultuar me kualitet të lartë të ujit në rrjetin e ujësjellësit në tërë rajonin. Njëkohësisht disa parametrat bazik kontrollohen edhe në mënyrëdigjitale 24 orë.

Duhet të theksohet se IKSH në Mitrovicë ka qenë aktive dhe kemi arritur marrëveshjen e shërbimit mbi kontrollimin e kualitetit të ujit, në mes të KRU Mitrovica" dhe këtij instituti.

## 5.3 Kemikatet

Gjatë tre mujorit, për trajtim të ujit të pa përpunuar është përdorur si koagulant kloruriferrik, ndërsa si dezinfektues klori i gazët në të dy ITU-të Shipol dhe Balinc si dhe sulfati i aluminit për ITU Zubin Potok. Nga tabela më poshtë shihet se gjatë tre mujorit të parë, shpenzimi për trajtim

të ujit të pa përpunuar janë: 53,322 kg klorurferik dhe si dezinfektues 9,066.78 kg klor i gazët dhe 2,335 kg sulfat alumini.

*Tabela 27. Sasia e kemikateve të shpenzuara gjatë muajve*

| Muaji | *Zubin Potok* | Shipol | Balinc | *Zubin Potok* | Shipol | Balinc |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Sulfati i aluminit (kg) | Klori gaz (kg) | | | Kloruriferrik (kg) | |
| Janar | 625 | 1,950 | 875 | 369.69 | 23,560 | 12,824 |
| Shkurt | 1,260 | 1,750 | 730 | 350.09 | 5,000 | 6,384 |
| Mars | 450 | 1,780 | 868 | 400 | 2,950 | 2,604 |
| Gjithsej | **2,335** | | | **9,066.78** | | **53,322** |

## 5.4 ITUN në Skenderaj

**ITUN në Skenderaj- gjatë tre mujorit**, janë trajtuar 148,433 m$^3$ ujëra të zeza. Gjatë tre mujorit të parë nuk ka pasur probleme teknike. Në laboratorin e impiantit merren 12 mostra dhe janë analizuar 27parametra, nga secila mostër dhe uji i trajtuar i plotëson kriteret për tu derdhur në lumë.

## *5.5 Raport i Njësive Operative*

**Raport i Njësive Operative-Raport i Njësive Operative-**gjatë tre mujorit të parë tri njësitë operative janë furnizuar me ujë me 5,216,509m$^3$, ndërsa për Komunat Veriore, Mitrovica e Veriut, Zveçan,së bashku me fshatin Suhodoll është furnizuar me 1,358,393m$^3$, siç shihet në tabelën më poshtë.

*Tabela 28 Furinizimi me ujë sipas njësive operative*

| Qyteti / Muaj | Mitrovica Jugore | Vushtrri | Skenderaj | Mitrovica Veriore | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| TM 1 | 2,966,540 | 1,723,164 | 672,562 | 835,288 | 6,197,554 |
| Totali | 2,966,540 | 1,723,164 | 672,562 | 835,288 | 6,197,554 |

**Njësite Operative Mitrovicë ,Vushtrri dhe Skenderaj** - gjatë tre mujorit, kanë pranuar 979ankesa sic shihet në tabelën në vijim, prej të cilave 565ankesa kanë qenë rrjetit të ujitdhe 414 kanë qenë për mirëmbajtje të rrjetit të kanalizimit.

NjësitëOperative, gjatë tre mujorit të parë, kanë qenë aktive në riparime të rrjetit të ujit, dhe në parandalimin e keqpërdorimit të ujit. Mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit, po arrihet që të përfundohen ankesat e konsumatorëve me sukses.

### *5.6 Sektori i mirëmbajtjes së automjeteve*

Sektori i mirëmbajtjes së automjeteve ka kryer aktivitetet të cilat kanë ndikuar në mënyrë që njesitë operative të jenë në nivel.

*Tabela 29. Parametrat e mirëmbajtjeve të rrjetit të ujit dhe kanalizimit TM2*

| Nr | Njesitë Operative | Njesia | Janar | Shkurt | Mars | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Parametrat e rrjetit te ujit | | | | | |
| 2 | Nr.i ankesave | nr | 176 | 164 | 225 | 565 |
| 3 | Nr.i ankesave të realizuara | nr | 176 | 164 | 219 | 559 |
| 4 | Nr.i ankesave të pa realizuara | nr | 0 | 0 | 6 | 6 |
| 5 | Numri i prishjeve në gypat kryesor të ujësjellësit nën Ø63mm | nr | 135 | 131 | 192 | 458 |
| 6 | Numri i prishjeve të riparuara në gypat kryesor të ujësjellësit nën Ø63mm | nr | 135 | 131 | 192 | 458 |
| 7 | Numri i prishjeve në gypat e kyçjes së ujësjellësit mbi Ø63mm | nr | 27 | 20 | 26 | 73 |
| 8 | Numri i prishjeve të riparuara në gypat e kyçjes së ujësjellësit mbi Ø63mm | nr | 27 | 20 | 26 | 73 |
| 9 | **Gjatesia e rrjetit të ujësjellësit** | **m** | **1,651,966** | **1,651,966** | **1,651,966** | **1,651,966** |
| 10 | Kyçje të reja në ujësjellës | nr | 15 | 64 | 6 | 85 |
| 11 | Montimi i ujëmatësve | nr | 17 | 31 | 4 | 52 |
| 12 | Riparimi i ujëmatësve | nr | 2 | 51 | 0 | 53 |
| 13 | Gjatësia e gypit të zëvendësuar | M | 133 | 159 | 176.5 | 468.5 |
| | **Rrjeti i kanalizimit** | | | | | |
| 1 | Ankesat | nr | 142 | 139 | 133 | 414 |
| 2 | Ankesat e realizuara | nr | 142 | 139 | 133 | 414 |
| 3 | Ankesat e pa realizuara | nr | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Nr. i përgjithshëm i pusetave të kanalizimit | **nr.** | **3,980** | **3,980** | **3,980** | **3,980** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Nr. i pusetave të kanalizimit të inspektuara | nr. | 48 | 37 | 20 | 105 |
| 6 | Gjatësia e rrjetit të kanalizimit të pastruar | m | 6,790 | 8,155 | 3,892 | 18,837 |
| 7 | Numri i bllokimeve në kanalizim | nr/copë | 84 | 102 | 108 | 294 |
| 8 | Gjatësia e rrjetit të kanalizimit | m | **282,201** | **282,201** | **282,201** | **282,201** |
| 9 | Kyçje të reja në kanalizim | nr/copë | 7 | 0 | 0 | 7 |

## 5.6 Planifikimi& Zhvillimi

*Tabela 30. Të dhënat e inkorporuara në GIS*

| Përshkrimi | 01.01.2026-31.03.2026 |
|---|---|
| Nr.i konsumatorëve në sistemin e faturimit | 57,112 |
| Nr.i konsumatorëve në GIS/EDAMS | 55,007 |
| Diferenca mes Faturimit -GIS | 2,105 |
| Nr.i konsumatorëve që kanë nevojë për verifikim-GIS | 45 |
| Konsumatorët : | 96,31 |
| Nr. I burimeve të ujit /marrjes -GIS | 1 |
| Rrjeti primar dhe sekondar | 91,54% |
| Nr. i FPU-GIS | 4 |
| Nr.Rezervuarëve -GIS | 66 |
| Nr.Stacioneve të Pompimit -GIS | 45 |
| Nr. i valvuleve operuse -GIS | 802-të hapura<br>15-të mbyllura |
| Nr. i valvuleve të ajrimit -GIS | 48 |
| Nr. i valvulave të redukimit të shtypjes -GIS | 14 |
| Nr.ujëmatësave zonal -GIS | 126 |
| Hidrant-GIS | 60 |
| Defektet-GIS | 1,238 |
| Pompa-GIS | 91 |
| Ujëmatësa në prodhim-GIS | 5 |
| Rrjeti i kanalizimit -GIS | 264.157km |
| Nr.Pusetave te kanalizimit-GIS | 7057 |
| Nr. defekteve -GIS | 1397 |

*Tabela 31. Kërkesat/Ankesat*

| Nr. | Përshkrimi i kërkesave | Viti 2026 | | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| | | I | II | III | |
| 1 | Numri i kërkesave të pranuara | 67 | 85 | 86 | 238 |
| 2 | Shqyrtimi i kërkesave | 64 | 81 | 85 | 230 |
| 3 | Kërkesa për Kyçje | 0 | 4 | 3 | 7 |
| 4 | Kërkesa për Ri- Kyçje | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Kërkesa për Legalizim | 18 | 26 | 22 | 66 |
| 6 | Kërkesa për ndërtesa shumëkatëshe | 3 | 1 | 1 | 5 |
| 7 | Kërkesa për pëlqime | 3 | 8 | 10 | 21 |
| 8 | Detektimi dhe hulumtimi i rrjedhjeve me aparaturë-Mitrovicë | 39 | 42 | 50 | 131 |
| 9 | Hulumtimi i rrjedhjeve në mënyrë vizuele | 1 | 0 | 0 | 1 |
| 10 | Evidentimi i konsumatorve në sistemin Gis për kyçje, Legalizime dhe pëlqime. | 64 | 81 | 85 | 230 |

## Raporti per hidroinxhinieret

- Përgaditja dërgimi i të dhënave teknike për: Impiantet e trajtimit, rezervuar, STP, rrjetin e ujit dhe kanalizimit, të kërkuara për projektin ËRIPS.
- Vendsoja e defekteve dhe debllokimeve në rrjetin e kanalizimit për tri NJ.O. - Mitrovicë, Vushtrri, Skënderaj.
- Verifikim i të dhënave të regjistruara në sistemin GIS, për konsumatorët dhe vazhdim i vendosjes së të dhënave për konsumatorët e ri dhe të mbetur për vendosje nësistemin GIS.
- Kompletimi i raporteve teknike.
- Takim me KIËER- Evidentimi i kyqjeve për zonen e përcaktuar DMA.
- Takimi me ËRIPS- Sigurimi i te dhenave te nevojshme Shapefile GIS- Skema operacionale te ujit, vendndodhja e infrastruktures kryesore(rezervuare, stacione pompimi, rrjeti i ujit, rrjeti i kanalizimit, impiantet e trajtimit te ujit...).
- Ne kuader te bashkpunimit institucional e i cili është një nder qëllimet e KRU-Mitrovica SH.A, zhvilloi Takim në selinë e Kuvendit Komunal-Leposaviq për të shqyrtuar mundësite e furnizimit më të mirë për atë pjesë.
- Takim me KIËER- Ka filluar faza 3, inspektimi I konsumatoreve te DMA- zones se percaktuar
- Takim me "Vision Projekt"- informim rreth dizajnimit te pendës se Kuqicës.
- Takim me KK-Mitrovicë, rreth koordinimit të projekteve të Komunës dhe KRU-Mitrovica, ashtu siq është përcaktuar edhe në PB të kompanisë sonë.
- Komisioni i Pranimit teknik te projekteve te perfunduara ne ujesjelles per Vushtrri", ka zhvilluar takim me KK-Vushtrri.
- Takim me Agjensionin e pyjeve dhe Ministrine e Pellgjeve Ujore, lidhur me projektin per furnizim me uje nga dy puse per Leposaviq.
- Identifikimi I projekteve per financim nga MZHE.

## 6. IMPIANTI PËR TRAJTIMIN E UJRAVE TË ZEZA – PROJEKTI

| | |
|---|---|
| Projekti: | **ID e Projektit: 50458 "Ndërtimi i Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza- Mitrovicë" - Vushtrri** |
| Implementues: | *Kompania Regjionale Ujësjellësi -Mitrovicë* |
| PA Lokacioni: | *Mitrovicë, Kosovë* |
| Datë: | *TM1 2026* |

ID e Projektit: 50458
**https://ecepp.ebrd.com/**
**Project:** Mitrovica Ëasteëater Development Project
**Procurement Exercise:** Project Implementation Consultant - Ëasteëater
**ECEPP ID**: 15306482
**http://ëëë.kru-mitrovica.com/trajtimi-i-ujerave-te-zeza/**

**Aktivitetet e Përfunduara**U percaktua vendodhja per ndertimin e Impiantit
**Vendndodhja e ITUN**Pasi te gjitha palët e përfshira ne projekt u pajtuan me Analizën - studimin e alternativave se, M1 është vendodhja e preferuar per ndërtim te ITUN Ndersa nga Konsulenca u kërkua perditesimi i dokumentacionit.

**Statusi Aktual,** Konsulenca eshte angazhuar që te bëj përditësimet e koncept dizajnit te Impiantit dhe rrjetit te kanalizimit ne përputhje me rrethanat e reja dhe përshtatja me lokacionin e ri – M1, Aktualishte kane filluar me viziten ne teren – marrja e mostrave nga derdhjet e kanalizimit ne lumejt Iber, Sitnica etj.

Hapat ne vazhdim, Përfshin përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe të tenderit, procedurat e shpronësimit dhe hapjen e tenderit për ndërtim sipas standardeve FIDIC (Libri i Verdhë).

**Zgjerimi Faza II, Mitrovic Veri, Zvecan.** Agazhimi i Konsulences per Perditsimin e Studimit te Fizibilitetit per Mitrovicen Veri dheZveçan i inicuar nga Qeveria e Kosoves i mbshtetur nga BERZH-it, kërkohet që dokumenti i përditësuar dhe i harmonizuar me standardet e BE-së dhe me fokus në qëndrueshmëri financiare dhe mjedisore, analizat dhe perditesimi i,

**FOPIP** - Përmasimi i Performances Tekniko-Financiare ECEP

Ne kuadër te Projekteve te financuara nga BERZH_i si pako shkon edhe FOPOI_i (Përmasimi i Performances Operative dhe Financiar te Kompanisë) qe financohet nga një grant ne vlere 337,500 euro nga shtetit i Zvicrës (Sëiss Agency for Development and Cooperation (SDC)

Përbëhet nga këto komponentë kryesorë:

Identifikimi i fushave prioritare për përmirësim: cilësia e shërbimeve, reduktimi i humbjeve (NRË), rritja e arkëtimeve, rritja e efikasitetit të kostove.

Përgatitja e një programi të detajuar për përmirësimin financiar dhe operacional: Ristrukturimi organizativ,Sistemet e MIS dhe IFRS, Performanca e stafit dhe racionalizimi, Politika e tarifave dhe analiza sociale, Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, Strategjia për NRË, Marrëdhëniet me konsumatorët.

Zhvillimi i Planit Afatgjatë të Biznesit (20 vjet)

Zhvillimi i Corporate Development Programme (CDP)

Raporti nga Komisioni i Vlerismit eshte dergu te Banka per (NO) mos- kundershtim dhe presim qe gjat muajit prillit te kemi kontraten per FOPIP.

## 7. ZYRA PËR INFORMIM RAPORTIM DHE MARDHËNIE ME PUBLIKUN

Gjatë periudhës tremujore **Janar – Mars 2026**, Zyra për Informim, Raportim dhe Marrëdhënie me Publikun ka vijuar aktivitetet e saj në mënyrë të strukturuar dhe profesionale, duke siguruar komunikim të vazhdueshëm, të qartë dhe transparent me konsumatorët dhe publikun e gjerë.

**Gjatë kësaj periudhe janë realizuar këto aktivitete kryesore:**

• Publikime të rregullta informuese për konsumatorët lidhur me detyrimet ndaj kompanisë, me synim rritjen e vetëdijes dhe përmirësimin e nivelit të arkëtimit;

• Njoftime të vazhdueshme për punimet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, duke përfshirë ndërhyrjet e planifikuara dhe rastet emergjente;

• Informim në kohë për ndërprerjet e furnizimit me ujë të pijshëm si pasojë e punimeve apo defekteve të papritura;
• Publikim dhe promovim i **konkurseve për pozita të lira pune**, duke garantuar transparencë, barazi dhe qasje të hapur për të gjithë kandidatët e interesuar;

• Njoftime për aktivitetet e ekipeve në terren, përfshirë kontrollet dhe masat ndaj kyçjeve ilegale;
• Informim për mundësitë e lehtësimit të pagesave, përfshirë riprogramimin e borxheve për konsumatorët;
• Fushata vetëdijësuese për përdorimin e përgjegjshëm dhe racional të ujit, veçanërisht gjatë periudhave me konsum të rritur.

### Shënimi i "Ditës Botërore të Ujit" – 22 Mars

Në kuadër të **22 Marsit – Ditës Botërore të Ujit**, Zyra ka zhvilluar aktivitete informuese dhe edukative në institucionet arsimore të komunave që mbulon kompania. Këto aktivitete kanë pasur për qëllim ngritjen e vetëdijes tek të rinjtë për rëndësinë e ujit të pijshëm dhe mbrojtjen e burimeve ujore.

**Aktivitetet e realizuara gjatë muajit mars përfshijnë:**

• Ligjërata edukative në shkolla fillore, të fokusuara në ruajtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të ujit;

• Vizita në Impiantet e Trajtimit të Ujit të Pijshëm dhe të Ujrave të Ndotura, ku nxënësit u njohën me proceset teknologjike të trajtimit dhe menaxhimit të ujit.

Aktivitetet kanë pasur pjesëmarrje të gjerë nga nxënësit dhe stafi arsimor. Të gjitha janë pasqyruar dhe publikuar në kohë reale në rrjetet sociale të kompanisë, duke rritur ndërveprimin me publikun dhe duke kontribuar në forcimin e kulturës së përgjegjshme ndaj ujit

## 8. PROKURIMI

*Tabela 32. Aktivitetet e Prokurimit*

| Numri rendor i prokurimit | Titulli i aktivitetit të prokurimit | Data e inicimit të aktivitetit të prokurimit | Data e publikimit të njoftimit për kontratë | Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës | Data e nënshkrimit të kontratës ( ne rast anulimi data e njoftimit për anulim) | Vlera e parashikuar e kontratës | Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj. | Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 |
| **KURM-25-237-1-3-6** | Furnizim me paisje për faturim mobil | 21.1.2025. | 22.1.2025. | 26.2.2025. | 25.2.2025. | 4,500.00 | 3,070.00 | Pattern SH.P.K. |
| **KURM-25-483-2-3-6** | Mirëmbajtja dhe përkrahja në sistemin Financiar (ERP) dhe atë të Faturimit (Billing). | 30.1.2025. | 3.2.2025. | 11.3.2025. | 5.3.2025. | 7,500.00 | 7,434.00 | ASEE SH.P.K. |
| **KURM-25-426-1-2-1** | Furnizim me pjesë fazonike për rrjetin e ujit | 29.1.2025. | 30.1.2025. | 19.3.2025. | 18.3.2025. | 60,000.00 | 47,876.00 | Xërxa Hidro Group SH.P.K. |
| **KURM-25-603-5-2-1** | Furnizimi me ujë të pijës për lagjen "Mazhiqët" në Vushtrri. | 27.1.2025. | 7.2.2025. | 24.3.2025. | 21.3.2025. | 25,000.00 | 23,745.38 | N.N.P. "HYSNIA" |
| **KURM-25-441-2-2-1** | Sigurimi shëndetësor i stafit të KUR Mitrovica Sh.A | 29.1.2025. | 31.1.2025. | 27.3.2025. | 26.3.2025. | 75,000.00 | 65,826.00 | Kompania E Sigurimeve Të Përgjithshme Siguria |

*Koment: Me lartë janë të paraqitura vetëm kontratat e nënshkruara, në proces tenderues gjatë këtij tre-mujori janë edhe 9 aktivitete të tjera.*